Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica
Teatri i Qytetit i Mitrovicës
Teatar Grada Mitrovice - City Theatre of Mitrovica

Në bazë te Nenit 16 te ligjit per teatrot Nr.04/L-106 dhe rregullores nr.05/2014 dhe 04/2019 per themelimin edhe funksionimin e Ansamblit Rezident të Teatrove Kombëtare dhe Teatrove të Qyteteve Komuna e Mitrovicës shpall.

KONKURS

Për aktor rezident në Teatrin,, Muharrem Qena''

Institucioni: DKRS /Teatri ,, Muharrem Qena''Mitrovicë

1. Titulli I pozitës: Aktorë/e
2. Nr. I pozitave : 10 (dhjetë)
3. Grada /koeficienti: 7
4. I përgjigjet : Drejtorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit artistik
5. Orari I punes: I plotë 40 orë në javë

Detyrat:

Të mësoj tekstin dhe të mbajë prova

-të hulumtoj dhe lexojnë material apo të ndërmarrin aktivitete fizike dhe intelektuale që ndihmojnë ne pregaditjen e rolit të tij/sajë në shfaqje.

-Të diskutoj interpretimin dhe të shfaq kreativitet dhe kolektivisht në bashkpunim me të tjerët dhe regjisorin:

-të përformoj drejtpërsëdrejti para publikut :

-të përformoj në studio apo lokacion tjetër varësisht nga nevoja që paraqet produksioni:

-të incizoj zëra varësisht nga nevoja e produksionit

-të kujdeset për hapsirën performuese, kostumet dhe rekvizitat:

-të mbaj mend tekstin dhe të gjitha funksionet tjera të veprës deri sa ajo vepër zyrtarisht të del nga repërtoari apo siq është specifikuar me kontratë:

-studion veprën dhe punon në mënyrë krijuese për jetësimin e artistik në përpunimin dhe trans pozicionin e rolit:

-bashëpunon drejtpërdrejt me regjisorin për të rrumbullaksuar rolin:-për punën e tij I pergjigjet regjisorit , udhëheqsit artistik dhe drejtorit të përgjithshëm.

Kushtet dhe shkathtësitë e kërkuara:

• Diplomë Universitare, Fakulteti i Arteve - dega e aktrimit

• Të kenë së paku tri vite përvojë pune profesionale aktive, ne realizimin e roleve në Teatër;

• Të dëshmojë talentin dhe përvojën e tij para audicionit që e organizon Komisioni profesional i Teatrit ,, Muharrem Qena'' Mitrovicë

• Të njohë gjuhën shqipe në nivel të shkëlqyer në të shkruar dhe lexuar, të domosdoshme dhe gjuhët tjera zyrtare, njohja e gjuhëve të huaja përparësi:

• Të ketë aftësi të mira profesionale dhe të jetë i gatshëm të punojë me orar fleksibil të punës

• Njohja e punës me kompjuter,Word, Excel; Përzgjedhja e aktorëve për ansamblin rezident bëhet përmes audicionit.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs: Të drejtë aplikimi kanë te gjithe shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësi profesionale për kryerjen e detyrave.

Aktet ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë rekrutimin: Ligji Nr. 04/L -106 për Teatrot , Rregullorja Nr. O5/2014 dhe Nr.04/2019 per Themelimin dhe Funksionimin e Ansamblit Rezident të Teatrove Kombëtare dhe Teatrove të Qyteteve

. Kohëzgjatja e emërimit: Aktorët që pranohen përmes Konkursit publik, marrin kontrata dy vjeqare me mundësi të vazhdimit, sipas suksesit dhe angazhimit të treguar të paraparë me Rregulloret e sipërcekura.

Dokumentacioni i kërkuar: • Diploma e fakultetit te Arteve, dega aktrim (Kopja e vërtetuar) • Vërtetim për përvojën ne fushën e aktrimit, fotokopja e Letërnjoftimit ,ekstrakti i lindjes , dy - rekomandime , Certifikatën që nuk jeni nën hetime.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën nr. 10 në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Në aplikacion duhet të cekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës dhe ti bashkëngjiten këto dokumente: diploma mbi kualifikimin, fotokopja e letërnjoftimit; ekstrakti i lindjes; dëshmi mbi përvojën e punës,certifikata që nuk jeni nen hetime dhe certifikata që dëshmojnë njohuri nga fusha përkatëse. Dokumentet duhet të jenë në njërën prej gjuhëve zyrtare të komunës. Kontaktet me telefon mund ti bëni në 028 – 532 104 dhe 028 515 559 .

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Konkursi është I hapur 15 ditë nga data e publikimit

Ud. Drejtor I përgjithshëm I Teatrit ,, Muharrem Qena **Mitrovicë 30/06/2020**

Ma.sc. Sabit Sheremeti _____